

Data 08.03.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

Blerje Goma per Automjete

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

34350000-5; 34352000-9;34352100-0

VLERA E FONDIT LIMIT:

7.750.000 (shtate milion e shtateqind e pesedhjetë mijë) lekë pa Tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Ndermarrja e Shwerbimeve Komunale Durres ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

c. *Formulari i ofertës ekonomike sipas Shtojcës 1*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, nenit 27, 28 ,29, 30 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë plotësohet nëpërmjet dorëzimit të Shtojcës 8

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"

(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit**. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Në përcaktimin e vlerës së xhiros vjetore autoriteti kontraktor i është referuar VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Seksionit III, Neni 43 pika 2, gërma (b).

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike".

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2020, 2021,2022) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

(Shënim: ky kriter vendoset vetëm në rastet kur vlerësohet nga autoriteti/enti kontraktor)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
 - a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
 - b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” nenit 40 pika 4 ku është përcaktuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, për të vërtetuar aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen nevojave të AK

Shënim: *Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.*

2. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes **një deklaratë**, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë **shërbimin e transportit** në adresat e përcaktuara nga autoritetet kontraktore.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër dërgimin e mallit në adresat e përcaktuara të AK-ve.

3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë **të paktën 1(një)** automjet per transportin e mallrave, të cilin duhet t’i ketë në pronësi ose me qira.

Per sa me siper operatori ekonomik te paraqes nje deklarate perkatese sipas formatit te meposhtem:

Nr.	Lloji i mjetit	Targa	Kapaciteti mbajtes	Statusi
1				Pronesi/qira/perdorim

Shenim 3.1:

Per mjetet me status perdorimi qira/hua perdorje te disponohet kontrata noteriale perkatese mes qiradhenesit dhe qiramarrsesit.

Për këtë mjet duhet të paraqesi librezë qarkullimi, akt kolaudimi, sigurimin e detyrueshëm të mjeteve.

Ne zbatim te ndryshimeve te reja ligjore Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentacionin e mesiperme pranë AK jo me vone se 5 dite nga publikimi i njoftimit te fituesit perfundimtar

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të cilat janë të nevojshme për transportin e materialeve të pastrimit në adresat e te gjitha autoriteteve kontraktore . Në zbatim të pikës 1 dhe pikës 6 të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet: “1.Bashkë me dorëzimin e kërkesave për

pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, ku përcaktohet “6. Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin...”

4. Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesi certifikate të origjines se mallit objekt prokurimi.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar sipas standartit CE/ ose ekuivalent dhe direktivave lidhur si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi

5. Operatori Ekonomik duhet të paraqese ne SPE Deklarate ne te cilen te mare persiper permbushjen e specifikimeve teknike duke cilesuar Inedexet e shpejtesise,peshes,vitin si dhe realizimin e afatit 10 ditor te levrimit te mallit objekt prokurimi.

Argumentim: Ne baze te nenit 36 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të siguruar nëse operatori ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar sipas kerkesave dhe specifikimeve.

Afati 10 ditor per levrimin e mallit objekt prokurimi kerkohet sepse gomat e automjeteve te AK jane tejet te amortizuara. Te ndodhur ne keto kushte kerkohet te ndrohen te gjith gomat e automjeteve.

6.Operatori Ekonomik Ofertues duhet të paraqesi Certifikatat ISO Si me poshte:

6.1 Ofertuesit duhet të paraqesin Çertifikate Personale ISO 9001:2015, të standartit ndërkombëtar të menaxhimit të cilësive dhe /ose të njevlefshme, të cilat do të garantonin cilësinë e produktit ose standart ISO më të avancuar, të perkthyer e noterizuar. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme dhe të lëshuar nga organizma të vlerësimit të konformitetit, të cilët janë akredituar nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtar akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Ne Çertifikate personale ISO 9001:2015 duhet të jetë e përfshirë Objekti i prokurimit.

6.2 Ofertuesit duhet të paraqesin Çertifikate Personale ISO 14001:2015, të standartit ndërkombëtar të menaxhimit të sistemit të mbrojtjes së ambientit/mjedisit, të cilat do të garantonin mbrojtjen ndaj mjedisit, të perkthyer e noterizuar. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme dhe të lëshuar nga organizma të vlerësimit të konformitetit, të cilët janë akredituar nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtar akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Ne Çertifikate personale ISO 14001:2015 duhet te jete e perfshire Objekti i prokurimit.

Argumentim: Në bazë të pikës 6, gërma b, pikës 8 dhe 9 të nenit të 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe pikes 1 të nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

- 7 Operatori ekonomik ofertues, ne ditën e hapjes së ofertave (perpara hapjes së tyre), pranë Autoritetit Kontraktor, pranë NSHK Durrës, duhet të paraqesë të protokolluara një moster për secilin ze të mallrave objekt prokurimi, sipas listës së kërkuar:

7.1Tabela:

Nr	Emërtimi	Indeksi peshes	Indeksi shpejtesise	Njesia	Sasia
1	Goma 9,5R17,5 C	120/127	M	Cope	1
2	Goma 205/70 R15 C	106/104	H	Cope	1
3	Goma 195/75 R16 C	110/108	H	Cope	1
4	Goma 8,5 R 17,5	121/120	M	Cope	1
5	Goma 11 R 22,5 TL	146/145	L	Cope	1
6	Goma 315/80 R 22,5 TL	156/154	M	Cope	2
7	Goma 13 R 22,5 TL	156/150	K	Cope	1
8	Goma 195/70 R15 C	104/102	R	Cope	1
9	Goma 440/80R28 (16,9R28 TL)	156/156	A2	Cope	1
10	Goma 195/ R 14C	106/104	R	Cope	1
11	Goma 12,5/80 R18 (340/80 R18) TL	143	A8	Cope	1
12	Goma 480/80R26(18,4 R26) /167B-TL	167	A8	Cope	1
13	Goma 10 R 22,5 TL	144/142	M	Cope	1
14	Goma 175 R16C	101/99	R	Cope	1
15	Goma 165/70 14C	89/87	R	Cope	1
16	Goma 155/70R12	86/84	R	Cope	1
17	Goma 295/80 R22,5	152/148	M	Cope	1
18	Goma 205/75 R17,5	124/122	M	Cope	1
19	Goma 215/75 R17.5	126/124	M	Cope	1
20	Goma 205 R14C	109/107	Q	Cope	1
21	Goma 195/75 R14C	106/104	Q	Cope	1
22	Goma 235/75 R17,5	143/141	J	Cope	1
23	Goma 225/75 R16	104	H M+S	Cope	1
24	Goma 215/55 R16	93	V M+S	Cope	1

Shenim: Per gomen ne Tabele me nr. rendor 6 perkatesisht (Goma 315/80 R 22,5 TL) sipas specifikimeve te paraqitura, duhet te paraqiten si me poshte:

- 1 gome duhet gome diferenciali (goma duhet te jete me lule ne forme kubike)
- 1 gome duhet gome e pare (goma duhet te jete me kanale te drejta)

7.2.Mostrat e kerkuara duhet te jene te paisura me etikete ne menyre qe te dallohet qarte marka ,numri i gomes,indexset e shpejtesise dhe peshes si dhe viti i prodhimit.Te dhenat e etiketes duhet te jene ne perputhshmeri mje te dhenat e gomes.

7.3. Mostrat duhet te shoqerohen me listen e gomave te paraqitura ke te jene shenuar te gjithë te dhenat,sasia dhe specifikimet.

7.4 Autoriteti Kontraktor ka të drejtën e kontrollit të mostrave të sjella me përputhshmerinë e specifikimeve të kërkuara dhe te kryeje analizat e nevojshme laboratorike nese do te shihet e arsyeshme.

Mosparaqitja e mostrave sipas kërkesave të mësipërme përbën kusht s'kualifikimi për vazhdimin e procedurës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar, në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/a dhe 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.Paraqitja e mostrave të kërkuara lidhet drejtpërdrejtë me verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të produkteve të ofruara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me ato të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. AutoritetiKontraktor është në të drejtën e tij të bazuar në legjislacionin e prokurimit publik dhe akteve nënligjorë të nxjerra ne zbatim te tij, për të kërkuar mostrat e mallrave, objekt prokurimi, për verifikimin e përputhshmërisë së tyre me specifikimet teknike, Vetë Komisioni i Prokurimit Publik lidhur me këtë kriter, aryseton: ...”KPP konstaton se për përmbushjen e këtij synimi, autoritetikontraktor ka parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit jo vetëm kriteret kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e kapacitetit teknik, por edhe kriteret të tjera kualifikimi, të cilat lidhen me vërtetimin e plotësimit të specifikimeve teknike të produktit me anë të dorëzimit të mostrave për disa prej produkteve objekt prokurimi...”Qëllimi i vendosur nga ligjvënësi përparaqitjen e mostrave, është dhënia e mundësisë autoritetit kontraktor, i cili është përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, të kryerjes së verifikimeve (ekzaminim, inspektim, testim) të mostrave të dorëzuara nga operatori ekonomik në rast se këto të fundit janë në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor të pasqyruar në specifikimet teknike të procedurës së prokurimit.

Shenim:

Referuar udhezimeve te APP, per zerat ne DST qe mund te jete paraqitur marke/brand, operatoret ekonomik mund te ofertojne ekuivalente te tyre gjate pergatitjes se ofertes ekonomike.

Shenim:

Mos dorezimi i informacionit te sakte apo dorezimi te rreme do te konsiderohet kusht per skualifikim dhe/ose fillim te hetimit administrativ per perjashtim te O.E. nga procedurat e prokurimit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuar, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

1. Gomat nuk duhet te jene te riveshura
2. Gomat duhet te kene te indeksuar marken dhe vendin e prodhimit.
3. Gomat duhet te perdoren ne çdo stine.
4. Sasia e nje numri gome duhet te jene te se njejtës marke prodhimi.
5. Operatori ekonomik duhet te kete ne objektin e aktivitetit (QKB) te drejte per shitje/sherbim gomash
6. Gomat duhet te jene prodhim sipas standartit nderkombetar ISO 9001-2015 ose standart ISO me i avancuar .
7. Garancia e gomave te automjeteve jo me pak se 40.000 km.
8. Garancia e gomave te jete jo me pak se 12 muaj nga lidhja e kontrates
9. Gomat duhet te jene Marke e regjistruar

10. Gomat duhet te jene standarti CE
11. Ne trupin e gomes duhet te dallohet qarte numri i gomes, indexi i peshes , indexi i shpejetsise, java viti i prodhimit si dhe markimi CE
12. Gomat duhet te jene prodhim jo me hershem se 12 muaj nga data e publikimit te njoftimit te kontrates, sepse: **Goma lenden kryesore ka elastomerin dhe nga moment i prodhimit deri ne fundin e jetes se gomes ky lloj materiali thahet dhe humb elasticitetin, duke u thare goma ne teresi behet e ngurte dhe sa me e hershme te jete data e prodhimit te gomes aq me e ulet eshte performaca e frenimit dhe e stabilitetit te mjetit ne rruge.**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Hartimi i specifikimeve teknike është kryer nga punonjësit e oficinës së NSHK Durrës duke iu referuar kërkesave dhe nevojave të autoritetit kontraktor NSHK Durrës në fushën e veprimtarisë së tij.